



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS SPANJOLLE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS

Letërsi e gjuhës B (1)

(Letërsia e Mesjetës dhe e Rilindjes)

Ngarkesa: Numri i krediteve 4 (katër), orë mësimore 40, Leksione 20 + Seminare 20

Viti / Semestri : Viti II ,semestri i dytë

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Hispanik

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT

Objektivat e përgjithshme lëndore: Ky kurs ka si objektiv të përgjithshëm t'i ofrojë studentit një vizion panoramik të letërsisë spanjolle Mesjetare dhe të Rilindjes- pjesë e Shekullit të Artë spanjoll, përmes studimit të etapave kryesore, rrymave dhe modaliteteve të kësaj periudhe. Më pas të njohë proceset e përgjithshëm të krijimit, receptimit dhe përhapjes së produktit letrar në gjuhën kastellane në mesjetë e Rilindje.

Objektivat specifike lëndore:

Në fund të kursit studenti është është i aftë:

- 1.Të dallojë zhanret kryesore letrare të kohës dhe të identifikojë veprat më të rëndësishme.
- të përvetësojë elementët kulturorë kryesorë në zhvillimin e historisë së letërsisë të cilët lidhen dhe me manifestime të tjera artistike e ndajnë, me shumë mundësi të njëjtin substrakt historik, shoqëror dhe ideologjik.
2. Të përdorë në një nivel bazë, një metodologji të analizës dhe interpretimit të historisë së letërsisë në përgjithësi dhe të veprave letrare kastellane në vecanti.
3. Të përvetësojë aftësi të leximit kritik/analitik të veprave letrare mesjetare dhe të periudhes së Rilindjes.
- 4 Të zhvillojë aftësi kritike/analitike dhe ekspozuese në lidhje me përmbajtjen teorike dhe praktike në një temë të caktuar

Rezultatet të pritshme:

- 1.Të jetë i aftë të njohë në mënyrë kronologjike lëvizjet letrare, rrymat, autorët dhe veprat.
- 2.Të formojë një mendim kritik mbi një tekst letrar.
- 3.Të trajtojë bibliografinë dhe dokumentacionin themelor të letërsisë në studim.
4. Të përgatitë detyrën e kursit në formë eseje dhe e prezanton me gojë para grupit të studentëve, bazuar mbi leximin e analizën e një romani të shkruar nga një autor spanjoll, në periudhën letrare në studim.